

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 24.09.2025		
Nr. Orgv Org. red 01K	Nr. Prot. Br. Prot. 98	Nr. Faqeve. Br. Strana. 02
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

Tel. 038.200 46 039 /045/
E-mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

Në bazë të nenit 26 të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Autoriteti Kontraktues harton këtë:

ANEKS KONTRATË (PUNË SHITESË)

Punë shtesë – Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve.

E lidhur më 24.09.2025 ndërmjet,

Komunës së Ferizajt, Zyra e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë të cilën e përfaqëson, znj. Arbërie Bektashi – Udhëheqëse e Zyrës së Prokurimit dhe në anën tjetër,

Operatori Ekonomik: "Linda", nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson në cilësinë e drejtorit z. Hysri Berisha, (në vazhdim "punë kryesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një aneks kontratë për punët e shënuara më poshtë:

I.

Kontrata bazë 01K nr.82/2024 e datës 23.07.2024, **Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve**, gjatë kryerjes së punëve janë paraqitur punë shtesë sipas procesit të organit mbikëqyrës. Autoriteti Kontraktues (Komuna e Ferizajt) me njoftimin në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) ka lejuar lidhjen e aneks kontratës për këto punë.

II.

Vlera e kësaj aneks kontrate për punët shtesë do të jetë: **91,750.00 € (Nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e zero cent)** e cila shumë është **9,99%** e vlerës së kontratës bazë. Vlera e kontratës bazë është: **917,777.77 € (Nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent)** të gjitha sipas paramasës së ofruar nga organi mbikëqyrës për punët shtesë dhe çmimeve për njësi të respektuara nga oferta bazë me të cilën është lidhur kontrata bazë.

III.

Kryesi i punëve, jo më vonë se dita e nënshkrimit të aneks kontratës, do të dorëzoj tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të aneks kontratës.

Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së aneks kontratës në vlerë prej: **9,175.00 Euro (Nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro e zero cent)**, valide nga një bankë e licencuar ose kompani e licencuar nga BQK-ja. Ky sigurim është valid **60 ditë**.

IV.

Punë kryesi detyrohet që punët shtesë të paraqitura në këtë projekt të filloj implementimin e tyre nga data e nënshkrimit të kontratës dhe deri më **14.10.2025** t'i përfundoj punë shtesë, sipas paramasave të përcaktuara nga organi mbikëqyrës.

V.

Autoriteti Kontraktues si organ mbikëqyrës për këtë aneks kontratë cakton z.Agim Dërguti – zyrtar në DI, i cili ka qenë mbikëqyrës në kontratën bazë të këtij projekti.

VI.

Autoriteti kontraktues merr për detyrim se pagesën e punëve të përshkruara në këtë kontratë do t'i bëjë punët në afat prej 11 ditësh nga data e marrjes së raportit mbi kryerjen e punëve nga mbikëqyrësi.

VII.

Kontraktuesit kanë arritur marrëveshjen se në rast kontesti për interpretimin e kësaj kontrate do të jetë kompetente Gjykata Themelore ne Ferizaj.

VIII.

Kjo kontratë është hartuar ne 4 kopje identike, palët kontraktuese pasi që e lexojnë të njëjtën me nënshkrimet e veta e pranojnë për të veten pa vërejtje.

KONTRAKTUESIT:

Operatori Ekonomik
"Linda"

z.Hysri Berisha



V.V.



Autoriteti Kontraktues
Zyra e Prokurimit

znj.Arbenie Bekteshi

V.V.



Garancion i Kualitetit të Punimeve

Polica : 10001259668

Për : KOMUNA FERIZAJ

DUKE PASUR PARASYSH QË: **Linda SH.P.K.** me adresë në: , ka marrë përsipër të postoj një siguri te realizimit lidhur me kontratën me numrin e kontrates: **656-25-7289-5-2-5 - 5 -** , për operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues me titull: **Pyllëzimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve**

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshoj një siguri për shumën e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri;

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në shumën totale prej:

9,175.00€ (Nëntë Mije e Një Qind e Shtatëdhjetë e Pesë Euro)

dhe ne marrim përsipër dhe ju paguajmë, me kërkesën tuaj të pare me shkrim që deklaron se Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse: Autoriteti Kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose

Operatori Ekonomik do të jetë përgjegjës për të rregulluar çdo defekt ose dëmtim të cdo pjesë të punimeve që mund të shfaqen gjatë periudhës së përgjegjësisë së defekteve që rrjedhin nga ose prej:

- Përdorimi i materialeve jocilësore ose të metat në ekzekutim të projektit gjatë realizimit të projektit dhe/ose
- Çdo veprim ose heqje dore i kontraktuesit gjatë periudhës së përgjegjësisë së defekteve.

Dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të: 9,175.00 € siç është thënë më lartë, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikar këtu.

Kjo siguri është e vlefshme prej: 24.09.2025 deri më: 24.10.2025



Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit
"PRISIG" SH.A.

Emri i Institucionit financiar
Rr.Eduard Lir Ob-2, Lagja Arbëria, Prishtinë
Data: 23.09.2025



Paramasa dhe paralogaria e punëve shtesë

Emri i projektit: Pyllezimi dhe rregullimi i parkut në kodrën e Sherretëve

RR	Paramasa me Paralogari PROJEKTI KRYESOR I INFRASTRUKTURES RRUGORE SHTEGU - A KM(0+000.00 - 0+888.87)
	1.0.SHTEGU - A

3	PUNET E MBISTRUKTURES				
	Pershkrimi I punimeve	Njesia	Sasi	Çmimi	Totali
3.1	Shtirja dhe ngjeshja e materialit te deponuar gjete germimit(pos.2.1) ne sektoret ku jane te projektuara mbushjet.Shtirja duhet te behet ne shtresa jo me shume se 25 cm dhe pas cdo shtirje te behet kompaktimi >40MN/m².Materiali I mbetur duhet te planifikohet brenda sipefaqes se punishtes.	m³	275.00	5.00 €	1,375.00 € ✓
3.3	Furnizimi, transporti, shtirja dhe ngjeshja e tamponit (50MN/m²) prej gurit te thyer gelqeror, 0-63mm me trashesi t=10cm.	m³	150.00	25.00 €	3,750.00 € ✓
3.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materiali i njetrajtshem AB16 me trashesi t=7,0cm	m²	1732.50	50.00 €	86,625.00 € ✓
	PUNET E MBISTRUKTURES				91,750.00 € ✓

NJ	RIKAPITULLIM RREGULLIMI I PARKUT TE KODRA E SHERRETEVE	
RR	Paramasa me Paralogari PROJEKTI KRYESOR I INFRASTRUKTURES RRUGORE SHTEGU - A KM(0+000.00 - 0+888.87)	91,750.00 € ✓

Kryesuesi : 

